

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Administratën e Kultures

Njesia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi nje mison auditimi te plote ne Administratën e Kultures per periudhen 01.01.2013 – 30.12.2014,ku nga auditimi rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Administrata e Kultures dhe institucionet perberese te saj,fuksionojne ne baze rregullores se bashkise per organet vartese,si dhe veprojne ne baze te planeve vjetore. Administrata e Kultures nuk ka sistem te kontrollit te brendshem,nuk ka te percaktuar objektiva,ka konflikt ne vendimmarrje,nuk ka kontroll te operacioneve financiare,nuk eshte ngritur sisitemi i monitorimit.Mungon rregullorja e brendshme sipas ligjit te menaxhimit financiar,planifikimi i buxhetit nuk eshte bazuar ne objektivat e institucionit. Mangesi ne ndjekjen e procedurave te prokurimeve publike,procedura likuiduese e aktivitetve kulturore nuk ndjek nje linj te rregull qe nga perpilimi i projektit,procedura tenderuese,kontraktuese,miratuese nga titullaret dhe likuidimi.Veprimet kontabel jane konform rregullave ,ka mangesi ne perpilimin e rregullores se asetëve.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1.Gjetje : Administra e Kultures nuk ka vendosur sistem të kontrollit të brendshëm, nuk ka përcaktuar objektivat, ka konflikt në vendimmarrje, nuk ka kontroll të operacioneve, këto veprime janë në kundërshtim me nenet 11.20.22 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”.

Rekomandim: Përshtatjen e rregullores së brendshme në përputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiare dhe kontrollin”, detajimin në mënyrë analitike të organizimit të burimeve në dispozicion, permiresimi i objektiveve, caktimi i përgjegjësisë, ndarja e detyrave, përcaktimi i pavarësisë, mënyra e llogaridhënies të të gjithë aktivitetëve që kryen çdo punonjës, detajimin e sistemit të kontrollit sipas institucioneve te Kultures.

2.Gjetje . : Në Administratën e Kultures nuk është ngritur sistemi i monitorimit, duke vepruar në kundërshtim me nenet 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”

Rekomandim

a. Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efikasitetit te institucioneve kulturor.

b. Te behet analiza e realizimit te objektiveve dhe brenda dates 15 Janar 2016 te informohet me shkrim Kryetare e bashkise lidhur me aktivitetin e Administrates Kultures.

3.Gjetje: Nga ana e Administrates se Kultures nuk rezulton te kete rregullore organizative te brendshem sipas ligjit te menaxhimit financiar. Nga ana e Administrates se Kultures nuk rezulton te kete kerkese drejtuar drejtorise se Burimeve Njerzore prane Bashkise ,te shoqeruar me kriteret perkatese per cdo vend te lire pune ose levizje te paralele apo ngritje ne detyre dhe vleresim te punes se cdo punonjesi.

Rekomandim: Perpilimi i pershkrimet te vendeve te punës, sipas pozicioneve, , vlersimi i punonjësve për rezultatet e arritura të paktën një herë në vit, krijimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit tekniko-administrativ.

4.Gjetje.Planifikimi i buxhetit nuk është bërë bazuar ne realizimin e objektivave te Administrates se kultures.

Rekomandim .Planifikimi i buxhetit te behet bazuar ne objektivat e Administrates kultures.

5.Gjetje Kerkesat per prokurim' nuk jane përpiluar nga drejtuesi funksional I institucionit si dhe nuk i jane drejtuar nëpunësit autorizues, veprim që bie në kundërshtim me nenet 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 02 datë 06.02.2012”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.Drejtuesi i institucionit duhet te sqaroje arsyen e kryerjes se shpenzimit, bashkangjitur specifikimet e mallit ose te shërbimit.

Rekomandimi: Kërkesa për shpenzim duhet ti drejtohet nëpunësit autorizues’Titullarit të bashkisë, kërkesa të vije nga drejtuesi funksional I institucionit shpenzues,së bashku me planifikimin dhe specifikimet përkatëse. Procedurat e Prokurimit me blerje të vogla duhet të kryhen nga subjekti shpenzues ,institucioni i varesise që kerkon blerjen apo shërbimin.

6.Gjetje.Për prokurimet me vlera te vogla, organizimi dhe planifikimi I shpenzimit, kryerja e procedures se prokurimit, është vepruar ne kundërshtim me piken 1,4,Udhëzimin nr 2 date 18.02.2008 “Prokurimi me vlera te vogla”

Rekomandim .Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla përfaqësues te institucionit te varesise ‘shpenzues’.

7.Gjetje.Faturat nuk janë të gjitha te formatit tatimor dhe të pa nënshkruara nga komisioni vlerësues dhe përfaqësues të Administratës së Kulturës,si dhe marrja ne dorëzim e mallit nuk është e nënshkruar nga komision të Administratës së Kulturës

Rekomandim .Perfaqësuesit e Administratës së Kulturës ‘Autoriteti Kontrator’ dhe komisioni vlerësues duhet të nënshkruajnë faturat tatimore si dhe marrjen në dorëzim e mallit apo shërbimit .

8.Gjetje.Dokumentacioni ligjor dhe teknik i prokurimit jo ne te gjitha rastet është i listuar dhe i nënshkruar,si dhe në të gjitha rastet i pa arshivuar.

Rekomandim .Dokumentacioni teknik dhe ligjor I procedurës dhe I operatorit ekonomik duhet të jetë në dosje I listuar ,I nënshkruar,si dhe ne përfundim të arkivohet

9.Gjetje.Mungojnë projektet të realizuara (si aktivitet dhe procedurë prokurimi) nga bashkia por të likuiduara nga Administrata e Kulturës,veprime që bien në kundërshtim me ligjin e Prokurimeve dhe “Menaxhimit Financiar”,si dhe në rastet ku ka projekte nuk janë brenda standarteve dhe nuk janë të miratuar nga bordi kultures,veprim që bie në kundërshtim me nenin 18 te ligjit nr.10352 datë 18.11.2010”Për Artin e Kulturën”

Rekomandim .Projektet kulturoro-artistike duhen të perpilohen ne mbështetje te një strukture të paracaktuar,duke përcaktuar qartë misionin,qëllimin,përftimet,pjesëmarrësit me detyra përkatëse,si dhe buxhetin analitik.Projektet duhen të miratohen nga bordi Kulturës. Për projektet duhet të zbatohet ligji i prokurimeve Publike,dhënia e mundesisë konkuruuese. Të njoftohet me shkrim Kryetari i Bashkisë për cdo hap të zhvillimit të aktivitetit.

10.Gjetje.Me personat pjesëmarrës ne aktivitete nuk është lidhur kontratë dypalëshe shërbimi,si dhe lista e personave pjesëmarrës nuk është nënshkruar nga bordi kulturës

Rekomandim .Në të gjitha rastet me personat pjesëmarrës në projekte duhet të lidhet kontratë dypalëshe shërbimi dhe lista të miratohet nga bordi kulturës.

11.Gjetje. Gjurma e auditit nuk është në përputhje me pikën 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2000‘Menaxhimit Financiar” dhe Urdhërit nr 92 datë 29.12.2011 të Ministrit të Financave”Për gjurmën e auditit për blerjet me vlera të vogla”.

Rekomandim Gjurma e auditit duhet të përpilohet nga juristi I prokurimit ,miratohet nga drejtuesi i Administratës së Kulturës ,si dhe miratohet nga Kryetari I Bashkise

12.Gjetje. Në këtë procedure nuk është i dokumentuar kontrolli i brendshëm i ushtruar nga drejtuesi i Administratës së Kultures dhe drejtori i drejtorise se Kultures,prane Bashkisë,veprim që bie në kundërshtim me nenin 11.20.22 të ligjit nr 10296 datë 8.07.2010 ” Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm”

Rekomandim .Në Administratën e Kulturës duhet të ngrihet dhe funksionojë sistemi i kontrollit të brendëshëm.

13.Gjetje.Është përcaktuar procedura e prokurimit negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, në kundërshtim me shkronjën c pika 2 neni 33 të ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, pasi nuk ka kushte të emergjencës pasi fondi limit për Karnavalet 2014 është përcaktuar përpara në buxhetin e vitit 2014.

Rekomandim: Të përcaktohet qartë procedura ligjore për kryerjen e prokurimit publik, se cilës fazë të prokurimit i përket dhe të ndiqet në mënyrë analitike zbatimi i buxhetit.

14.Gjetje: Sipas kontrates së furnizimit dt. 28.02.2014 te lidhur mes autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik sipas nenit 17.2 malli do dorëzohej ne magazinës e Bashkisë Shkoder, pas verifikimit rezulton që malli nuk është dorëzuar në magazinë.

Rekomandim: Të bëhet dorëzimi i mallrave në magazinën e Bashkisë Shkoder, sipas përcaktimit të vendosur në kontraten dy-palëshe të furnizimit.

15.Gjetje: Ka mangesi në perpilimin e rregullores asetëve, ndertimin e planit për mirmbajtjen e asetëve .

Rekomandim: Instruktimin e personelit pranë Bashkise Shkoder për ndertimin e planit për mirmbajtjen e asetëve dhe për perpilimin rregullores asetëve

**Njesia Auditimit Brendshem
Bashkia SHKODER**